DEKRET
Nr. 13413, datë 13.1.2022

PËR SHPALLJEN E PROCEDURËS SË APLIKIMIT PËR PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 93, 125, 127, pika 1/b, 3, 179, pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës, si dhe të neneve 7, 7/a, 7/b, 86, pika 4, shkronja "d", të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, pas administrimit të shkresës nr. 11 prot., datë 7.1.2022, të kryetares së Gjykatës Kushtetuese, me të cilën njoftohet se Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 42, datë 22.12.2021, ka vendosur: "Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Përparim Kalo, në datën 8.4.2022", për shkak të përfundimit të mandatit 9-vjeçar të plotësuar prej tij, me cilësinë e organit të emërtesës,

DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e procedurës së aplikimit për emërim gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me qëllim plotësimin e "Vakancës së plotë", me mandat 9-vjeçar, që krijohet më datë 8.4.2022.

Neni 2

Shpallja e kësaj procedure dhe publikimi i saj, sipas tekstit bashkëlidhur, të bëhet menjëherë në mjetet e informimit publik dhe në faqen zyrtare të internetit të Institucionit të Presidentit të Republikës.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Ilir Meta